



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1566/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Krenar Berisha, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit të sigurimit P.R, Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit A.G avokat nga Gjakova, ndaj kundërshtarëve të sigurimit 1.H.Z, aksionare dhe drejtoresh menaxhuese në Z... Sh.p.k, Gjakovë, 2. Z... Sh.p.k Prishtinë dhe 3. O... Sh.p.k Prishtinë të cilin i përfaqëson sipas autorizimit P.P avokat nga Gjakova, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit të sigurimit e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike I.EK.nr.613/21 e dates; 31.01.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën; 03.10.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e propozuesit të sigurimit P.R, Prishtinë, dhe **VËRTETOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike I.EK.nr.613/21 e datës 31.01.2022.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimor I.EK.nr.631/21 e dates;31.01.2022, ka vendosur si në vijim;

“Refuzohet në tërësi si e pa bazuar propozimi i propozuesit P.R, aksionar në shoqërin Tregtare “Z...” Sh.p.k me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër kundërshtarëve të sigurimit 1.H.Z, aksionare dhe drejtoresh menaxhuese në Z... Sh.p.k Gjakovë, 2. Z... Sh.p.k Prishtinë dhe 3. O... Sh.p.k Prishtinë, me të cilën ka propozuar që t’i ndalohet kundërshtares së sigurimit H.Z, që të ndërmarrë veprime me qëllim të shpërndarjes së Shoqërisë Tregtare “Z...” sh.p.k; ti ndalohet Shoqëria Tregtare “O...” sh.p.k që për çdo veprim që merr, të sigurohet nënshkrimi nga tre aksionarët e të njëjtës Shoqëri Tregtare, deri në vendosjen meritore të çështjes.”

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë propozuesi i sigurimit përmes të autorizuarit të tij, për shkak të të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar ndërsa aktvendimi i ankimuar të anulohet , dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Kundërpropozuesit përmes të autorizuarit të tyre kanë paraqitur përgjigje në ankesë, me të cilën kanë kërkuar që ankesa e propozuesit të refuzohet dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e ankimuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208 dhe 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se propozuesi i sigurimit P.R nga Prishtina , përmesë të autorizuarit të tij, në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, ka paraqitur propozim për caktimin e masës së sigurisë , duke theksuar se kundërshtarja e sigurimit H.Z ka filluar procedurën e likuedimit të Z... sh.p.k pa vendim unanim të të gjithë aksionarëve, pa e mbajtur kuvendin e aksionarëve dhe pa siguruar nënshkrimin e të gjithë aksionarëve,por vetëm më email të datës 30.08.2021 e ka njoftuar propozuesin se me datën 01.09.2021 hynë në mbyllje Z... sh.p.k sipas afateve ligjore dhe procedurave pranë ATK-së, ka shtuar se këto veprim të kundërshtarit të sigurimit janë në kundërshtim me Statutin e Z... Sh.p.k, dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Shoqërin Tregtare , andaj me këto veprime është dëmtuar interesi pronësor i propozuesit të sigurimit i cili ka pjesëmarrjen prej 24.5% të pronës së gjithëmbarshme të asaj shoqërie tregtare dhe se ekziston rreziku në realizimin e kërkesës së tij nga se me vet faktin e hedhjes në likuedim të Kompanisë, aksionet e tij prej 24.5% do të shuehshin pa vullnetin dhe votën e tij dhe pa asnjë kundërvlerë,po ashtu ka shtuar se kundërshtarja e sigurimit H.Z duke vepruara me keq besim e ka hapur një kompani tjetër me emrin O... sh.p.k madje duke i përdorër asetet e Kompanisë Z... sh.p.k, dhe krejt në fund ka propozuar që të caktohet masa e sigurisë që t'i ndalohet kundërshtares së sigurimit H.Z, që të ndërmarre veprime me qëllim të shpërndarjes së Shoqërisë Tregtare “Z...”sh.p.k; ti ndalohet Shoqëris Tregtare “O...”sh.p.k që për çdo veprim që merr, të sigurohet nënshkrimi nga tre aksionarët e të njejtës Shoqëri Tregtare, deri në vendosjen meritore të çështjes, ndërsa në seancën dëgjimore me datën 02.11.2021 i autorizuari i propozuesit të sigurisë ka bërë zgjerimin e propozimit me të cilën ka kërkuar që të obligohet kundërshtari i sigurimit Z... sh.p.k që propozuesit të sigurimit ti dorëzoj në kopje dokumentet e Shoqërisë Z... sh.p.k me seli në Prishtinë si në vijim; raportet financiare për vitin 2018,2019,2020, dhe 2021, përfshirë të hyrat, shpenzimet e shkaktuara, borxhet eventuale, listën e aseteve, listën e pagesave kesh, kontratat e nënshkruara me klient, çofshin ata vendor apo ndërkombëtar të dhënat lidhur me grante, apo fonde të përfituara, listat e pagave, dhe dokumentet tjera relevante.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë ka mbajtur senacën ndëgjimore dhe ndërgjyqësit kanë paraqitur pretendimet e tyre sa i përket bazueshmërisë së propozimit dhe pas përfundimit të seancës gjyqësore, ka marr aktvendimin e ankimuar me arsyetim se nuk është plotësuar asnjëra nga kushtet e parpara në nenin 297 të LPK-së, dhe se kërkesat e propozuesit për caktimin e masës së sigurisë në këtë fazë të procedurës nuk janë bërë të besushme, për shkak se propozuesi nuk ka paraqitë ndonjë provë se është inicuar procedura e shuarjes vullnetare pranë ARBK-së apo procedura e falimentimit pranë gjykatës, ndër të tjera në arsyetimin e aktvendimit të ankimuar thekson se shoqëria O... sh.p.k është person juridik në vete dhe ka veprimtarinë e saj të pa varur nga veprimtaria ekonomike e Z... sh.p.k, prandaj të njejtës nuk mund ti ndalohet ushtrimi i veprimtarisë tregtare për të cilën edhe është rregjistruar pranë

organit kompetent shtetëror, ka shtuar se çështja e veprimeve dhe vendimeve që merren në Z... sh.p.k dhe e drejta e aksionarëve të saj në votim ,janë çështje të rregulluar me statutin e Z... sh.p.k dhe LSHT, krejt në fundë ka theksuar se edhe sipas nenit 105 të LSHT është përcaktuar në mënyrë të qartë se aksionarët kanë të drejta të barabarta në votim dhe se të gjitha vendimet në SHPK merren me shumicën e thjesht të votave, ndërsa për disa çështje specifike nevojitet vota unanime e të gjithë aksionarëve në kuvendin e aksionarëve , ku përfshihet edhe vendimi për shpërbërjen e Shpk-së ose dërgimin në procedur të falementimit, kjo dispozitë ligjore siguron aksionarin e Shoqërisë Tregtare në këtë rast propozuesin e sigurimit se nuk mund të zhvillohet procedurë e shpërbërjes vullnetare apo të falimentimit pa u dhënë pëlqimi i tij.

Dhoma e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i ankmuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e shkallës së dytë e mori këtë qëndrim juridik sepse sipas nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së parashihet se *“Masa e sigurimit mund të caktohet ; a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besushme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe b) në qoftëse ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtill pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështërsonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen e ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.”*

Bazuar në dispozitat e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit duhet të plotësohen kushtet ligjore në mënyrë komulative sipas të cilave propozuesi i sigurimit duhet ta bëjë të besushme ekzistimin e kërkesës si dhe ta bëjë të besushme faktin se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështërsonte dukshëm realizimin e kërkesës së tij. Në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se propozuesi i sigurimit në këtë fazë të procedurës, nuk ka ofruar prova bindëse lidhur me besushmërinë e kërkesës së tij, me të cilat do të vërtetonte pretendimet e tij lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë.

Po ashtu në rastin konkret nuk plotësohet as kushti i dytë ligjorë për caktimin e masës së sigurimit sepse propozuesi nuk ka ofruar ndonjë provë se kundërshtari i sigurimit do të mund të pamundësojë apo vështërsoj dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër , me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit, ngase duke u bazuar në nenin 102 të Ligjit për Shoqëri Tregtare ku ligjëvënsi ka paraparë kompetencat ekskluzive të Kuvendit të Aksionarëve si organ më i lartë vendimarrës i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar si dhe sipas nenit 105 të të njejtit ligj është përcaktuar e drejta e votimit, andaj nga këto dispozita ligjore rezulton se cdo veprim i pa autorizuar që ka për qëllim shaktimin e dëmit apo vendim që merret nga kundërshtarët e sigurimit në kundërshtim me statutin dhe Ligjin për Shoqëri Tregtare i bartë edhe pasojat juridike.

Ndërsa, në drejtim të zgjerimit të propozimit i cili është bërë gjatë seancës ndëgjimore nga ana e propozuesit me datën 02.11.2021, e që gjykata me aktvendimin ankimor nuk ka vendos, por në drejtim të këtij zgjerimi të propozimit nuk është paraqit me ankesë nga asnjëra palë ashtu që gjykata e Dhomës së Shkallës së Dytë nuk ka mundësi ligjore që të vendos në mungesë të ankesës. Në rastin konkret pala nuk ka kërkuar plotësimin e aktvendimit ashtu sipas nenit 162 paragrafi 1 dhe 2 lidhur me nenin 164 paragrafi 3 të LPK-së, ashtu që konsiderohet që pala është tërheq nga ajo pjesë e propozimit.

Dhoma e Shkallës së Dytë i vlerësoj pretendimet ankimore të propozuesit të sigurimit por gjeti se të njejtat nuk përbëjnë arsye që kanë mbështetje ligjore, e për të cilat duhet të priset aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë , ngase aktvendimi ankimuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, sepse e njejtat me të drejtë nga vlerësimi i provave që gjenden në shkresat e lëndës ka gjetur se nuk janë përmbushur konditat ligjore të parpara me dispozitën e nenit 297 pika a) dhe b) të LPK-së, për caktimin e masës së sigurisë.

Nga të cekurat më lartë e në mbështetje të dispozitës së nenit 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË,
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1566/22,data 03.10.2022**

Kryetarja e kolegjit-Gjyqtarja
Franciska Zhitija Ymeri